AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR WEB

Pilot trajnim – Menaxhimi i Ngacmimeve Seksuale gjatë Regjistrimit të Popullsisë 2024

20.12.2023
Në kuadër të aktiviteteve të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024, sot u mbajt Pilot-trajnimi mbi Menaxhimin e Ngacmimeve Seksuale gjatë procesit të Regjistrimit të Popullsisë 20024, mbështetur nga UNFPA.

Në këtë pilot trajnim përveç stafit të ASK-së, mori pjesë edhe udhëheqësja e Zyres së UNFPA-së në Kosovë, Dr. Visare Mujko Nimani, e cila tha se Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është institucioni parë në Rajon që ka marrë këtë iniciativë për mbajtjen e këtij pilot trajnimi shumë të rëndësishëm për procesin e Regjistrimit të Popullsisë 2024.

Gjatë pilot-trajnimi u zhvilluan tri module: 1. Definimi i ngacmimit seksual, 2. Menaxhimi i ngacmimit seksual dhe 3. Menaxhimi i ngacmimit seksual gjatë Regjistrimit të Popullsisë 2024.

Ndër të tjera, trajnerja, Brikena Avdyli, potencoi edhe disa mekanizma që duhet ndërmarrë në rast të ngacmimeve seksuale në vendin e punës e konkretisht gjatë Regjistrimit të Popullsisë 2024.